R E I K I

Metodë alternative-tradicionale e shërimit me bioenergji

P.S. Kjo broshurë është një doracak teorik nga kurset e trajnimit praktikë të aplikantëve të rinjë të REIKI-shërimit me bioenergji

Autorizimin per editimin e ketij libri në internet, e kanë vetëm WEB faqet shqiptare: www.syri3.com dhe www.sa-kra.ch

Çdo editim i paautorizuar nga faqet tjera te internetit, do të konsiderohet pirateri!

Reiki ka ndikim të pazakonshëm dhe fare të qetë, të pahetueshëm, ashtu që mund edhe të mos e vërejmë, se çfarë na ngjetë në vetëdijen tonë shpirtërore, kulmin e subjeltiviymit tonë.

Disa prej njerëzve janë shumë të aftë të përvetësojnë dijen dhe teknikat e dijes, respektivisht të nxënjes; të tjerët janë fare të mbyllur në trup e shpirt, ndërkaq një lagje tjetër kanë ca pika, respektivisht ca predispozita për vetmbyllje.

Secili njeri ka të drejtë të zgjedhë mënyrën e trajtimit të vetvetes, respektivisht të kërkojë e gjejë mënyra e rrugë për shërimin e sëmundjes së tij. Ndoshta në atë çast ajo ndodhet në procesin e rritjes.

Mësohuni të jipmi, por edhe të nxini (mësoni) nga metoda shëruese e Reikit, pa qenë i varur, respektivisht i kushtëzuar. Reiki ndikon aty ku vihet në shfrytëzim energjia dhe jo përherë atje ku ne dëshirojmë dhe kemi nevojë.

Disa mendime rreth Reikit:

Ndihma shpirtërore është një dhuratë nga lartë dhe në fakt e paçmueshme, që d.t.th. nuk blehet me para. Përmes aktivitetit transferues shpaguhet në një farë mënyre angazhimi personal i energjive dhe kohës së mjeshtrit Reiki.

Usui Shiki Ryoho = Metodën e shërimit shpirtëror të Usuit

Besueshmëria vë në lëvizje zhvillimin personal. Kështu edhe errësira ka si kundërpeshë refleksive dritën, ashtu krijohen rrethanat, që ato t' i kundërvihen njra – tjetrës.

Bëhu gjithmonë i vetëdijëshëm, si të ishe vet Shëruesi Reik, se Ti je vetëm një kanal, përmes të cilit rrjedh energjia hyjnore. Besoi energjisë dhe lëre atë të rrjedhin, pa pretenduar që t' i kundërvihesh me betonimin, respektivisht vënjen në pah, të dëshirës sate personale. Kjo energji intelegjente e gjenë përherë rrugën e mirëfilltë të ndikimit.
Guximi, vendosmëria, të qenunit i kënaqur dhe dashuria e qiltër janë thekse të rëndësishme të karakterit. Beso në të mirën në jetë dhe bëhu bartës i dritës.

Pajtimi rreth të cilit dakordohet Riki para trajtimit

Mbrojtja nga rrezet e diellit

Ekspozoju rrezeve të diellit , kur ai depërton përmes reve.

Tashmë je tërësisht i shlirë, i shtrirë në tokë, me këmbët paksa të hapura... Mbylli sytë dhe ngriti duart lart përballë dritës ...
Shuplaka le të mbetet e shtrirë në lartësinë e supeve. Ti tashmë e ndjenë se si drita ngadalë ka filluar të depërtojë në brendinë tënde, të të mbushë çdo pore tënden. Këtheje shuplakën e dorës nga dielli dhe kai rrezet e diellit me majat e gishtrinjëve. Këto rreze do t'i ndjeshë si mburojë të trupit tënd, madje deri në majat e gishtrinjëve të këmbëve. Kështu tashmë e ndjenë se je i veshur nga një vello e hollë drite dhe ke filluar ta ndjeshë se je i mbrojtur dhe i mbushur plot gaz, që do të shoqërojë tërë ditën. Disponimin tëndë duket se nuk do të mund ta çart askush.

Parafytyroji tashti dëshirat tua që do të duhej të përmbusheshin. Ti edhe më tej do të kesh mundësi të lutesh, madje edhe për çështje të natyrës materiale. Kjo është energjia për të cilën ti tashmë ke nevojë, që do të të shërbente për realizimin e gjakimeve (dëshirave) tua më të rëndësishme.
Edhe njerëzit tu, të cilëve ti do të dëshiroje në mënyrë të veçantë t' ju ndihmosh, vëri në këtë rreth, respektivisht brenda kësaj velloje prej drite, që tashmë të shërben si vello mbrojtëse.

Ky llo meditimi, le të zgjasë kështu 2-3 minuta, dhe si i tillë është më I vlefshëm se meditimi i mëngjesit. Nuk guxon kurrsesi të harrosh se, njerëzve tu mund t'ju ndihmosh më shumë e më mirë, vetëm nëse Ti vet je shëndosh dhe i ekuilibruar. Për këtë arsye ruaje veten kurdoherë, sa e si ke nevojë.

Meditimi i trëndafilt

Ulu fare shlirshëm dhe mbylli sytë. Lëri supet të varen poashtu shlirshëm.
Merr frymë thellë dhe lëshoje...

Paramendo se je duke ndenjur në një kopsht plot me trëndafilë. Ngjyra e kuqe e tyre valëronë në të trëndafiltë drejt së kuqes së mbyllur. Ti tashmë e shijon aromën e tyre. Rri ashtu pa lëvizur dhe shijoje atë aromë të këndshme. E vëren se përmbi kokën tënde ka filluar të notojë re e trëndafiltë arome. Ajo ngadalë zbret tek ti dhe të të mbushë shpirtin plotë jetë. Qëndro një qast nën pushtetin e kësaj reje.
Përmes shëstimeve (mendimeve) përqëndrohu dhe thuaja vetes tri gjëra të rëndësishme:

- Jam në paqë e harmoni me tërë energjinë e dritës.
- Çdo gjë që do të mund ta shembte paqen dhe harmoninë tek unë, do ta mohojë dhe do ta çojë në theçafje...
- Unë e dua vetëm një person, të cilin më parë nuk kisha arritur kurrë ta dua. Po e parafytyroj atë person në formë siluete (fotografie) dhe them: Të dua dhe të të dërgojë dritë.

Mendo përherë në atë se TI gjithashtu edhe VETVETEN duhet ta duash.
Thithe tërë atë re trëndafili me tërë grykësinë e mundshme dhe kështu mbushe trupin tënd. Dashuria do të ta mbush zemrën tënde. Dashuria të shoqëron kudo. Ti tashmë mund të sponzorosh (reflektosh e dhurosh) dashuri.
Tashi eja ngadalë në realitet, lëvizi duart dhe këmbët dhe hapi së fundi edhe sytë.

Domethënja e shakrave-djerësitjes së këmbëve

Çka është shakra-djerësitja e këmbëve?

Ajo është metoda më e thjeshtë e tokës dhe e natyrës përmes së cilës mund të përcillet (ipet) energjia e Reikenit.

Prandaj mund të thuhet se tashti është çasti më i mirë për të bërë diçka për natyrën.

Kjo djerësitje d.t.th. edhe hapje e shakrave të këmbëve. Kjo d.t.th. se është më mirë që të kthehemi në tokë, ose me vetëdije të vihemi në kontakt me tokën. Prandaj mund të thuhet se këmba është pasqyrë e trupit. Në këmbë janë të përqëndruara të gjitha reflekset dhe aty fillojnë ose përfundojnë shumë vija meridiani. Kjo d.t.th se aty kemi përforcimin e bazës sonë.

Lëre dritën të përshkojë nëpër duart dhe këmbët tua.

Djerësitja e shakrave (shputave) të këmbëve d.t.th. se është çasti të pranosh nënshtrimin qoftë para nxënësit, qoftë para mjeshtrit.

Rruga për përsosjen e vetvetes

Marrja e energjisë

dhënja e energjisë dhënja e energjisë

Dhënja e energjisë

Arteriet/rrugët e energjisë kanë një shtrirje gadi sikur ato të shakrave, por ato dallojnë nga njeriu në njeri. Kjo dallueshmëri varet prej asaj se sa individi ka të zhvilluar ndjeshmërinë në tërësinë e saj, ose varsisht prej asaj se sa individi ka të përsosur ndjeshmërinë shpirtërore. Pranimi i energjisë përmes arterieve të saj paraqet fenomenin e pranimit, marrjen e frymës, respektivisht thithjes së energjisë së kosmosit, ndërkaq shperndarja, dhënja e saj përmes duarve dhe këmbëve, paraqet lëshimin. Ajo çka ndodhë në fakt paraqet qarkullimin e energjisë së eterit. Pra kemi një sistem të marrjes dhe lëshimit të ajrit dhe sërish përsëritjes së këti procesi. Përmes këti procesi do të mund të njihej pulsimi i jetës, me çka do të njihemi njëkohësisht edhe me procesin e ndërvartësisë ndaj gjithëçkaje dhe me gjithëçka.

Mendime mbi përputhshmërinë e çakrave të këmbëve

Kush ka këmbë të ftohta?

Me cilën këmbë je zgjuar sot ?

Me që këmbëve janë të paktë ata njerëz që u kushtojnë vëmendjen e duhur, është fare e lehtë që të konstatohet se, në këto pjesë të trupit, shpesh ose kemi më pak energji (këmbë të ftohta) ose çarkullim energjie në formë vërshimi (këmbë të nxehta). Megjithatë më shumë njerëz ankohen se kanë këmbë të ftohta. Kjo mungesë energjie, ose ky vërshim i energjisë, ndikon në debalancimin e energjisë që merr trupi nga jashtë me atë që jep. Si rezultat i këti debalcimi vije pastaj deri te sëmundjet e ndryshme. (Vështërsitë me veshkë dhe mëshikëza shpesh mendohet se janë si rrjedhojë e këmbëve të ftohta).
Krahas shtatë çakrave kryesore, në ndërkohë merremi edhe me çakrat anësore. Nga dy të tilla ndodhen në duar dhe këmbë. Këto katër çakra janë përgjegjëse për qarkullimin e energjisë nga jashtë brenda organizmit. Kështu çakra e dorës së djathtë është përgjegjëse për rregullimin e procesit të qarkullimit të energjisë nga brenda trupit për jashtë. Nëse në këtë çakër rrjedha e energjisë shrregullohet përmes farë pengese, atëherë njeriu nuk mund të veprojë drejt, ngase ai tashti nuk posedon të ashtuquajturën “gjendje të natyrshme për veprim të drejtë”. Ndërkaq nëse venerojmë analogjinë me çakrën e këmbës së djathtë, shohim se njeriu nuk është , si të thuash, me të dy këmbët në tokë, ngase e djathta tregon lëvizje, start. Në dorën e djathtë dhe në këmbën e djathtë, kemi çakrën që përçon energjinë pozitive ose energjinë e Jang-ut, e cila qarkullon nëpër trup.

Çakra e dorës së majtë, përkundrazi, bënë rregullatorët e pranimit të energjisë nga jashtë. Ana e majtë është përherë ana e ndjenjave. Kështu çakra e dorës së majtë dhe atjo e këmbës së majtë përcaktojnë përceptimin e valëve të ndjesisë, ngjashëm me valët energjetike, dhe si të tilla edhe regjistrohen. Në rast së ndonjëra prej këtyre çakrave nuk funksionon si duhet, atëherë njeriu ka vështërsi për pranimin e impulsave nga jashtë: njeriu sillet qartaqejfas; thuhet se ai është ngitur në këmbë të majtë...

Këtu kemi të bëjmë me pranim të energjisë negative ose energjisë së Yin-it.
Që ta ndjejmë dhe t' i kënaqemi harmonisë sonë, do të duhej të angazhoheshim në mbrojtje të barazpeshës dhe në këtë kuadër është me rëndësi që, çakrat e këmbëve dhe ato të duarve, si ato që përshkojnë enegji pozitive, ashtu edhe ato që përshkojnë energji negative, të anës së djathtë dhe asaj të majtë, të shkëmbejnë energji më njëra tjetrën.

Vetëm në këmbët që përshkohen nga procesi i balancimit energjetik, çakrat mund të funksionojnë tërësisht. Ato bëjnë rregullimin e procesit të ngarkimit dhe të shkarkimit të energjisë, që quhet edhe OD. (Od [e folmja e vjetër veriore oδr = ndjenjë; nga kimisti dhe filozofi gjerman mbi natyrën C.L.v. Reichenbach (1780-1869)]; ky –[e]s: me pretendime se rrezaton nga trupi i njeriut, jetës i jep fuqi.)
Ato bëjnë rregullimin edhe të procesit të shkarkimit të çakrave tjera. Kjo është energjia rrjedhese, është elementi themelor që ta ndjejmë trupin mirë e si duhet.

Me çakrat e këmbëve ne ndërlidhemi, jemi në kontakt me tokën-nënë; me çakrat e kurorës ndërlidhemi, jemi në kontakt me diellin-baba. Ne jemi të lindur në këtë polaritet; rrënjët janë të kushtëyuara nga drita, ajo don të manifestohet edhe te to.

Kjo informatë është tepër e besueshme dhe e destinuar vetëm për ty.

Simbolet e Reiki-it rizbulohen prej Dr. Mikao Usui-t

SHK - Simboli për shërim mental	Rend në rrafshin psikologjik. Risjell gjërat nga rrafshi i pavetëdijes në atë të vetëdijes.
CR - Dritë-Fuqi shëruese-Simbol	E shpejtë si vetëtima. E pavetëdijshmja merr më shumë fuqi.

HS – Simbol për shërim nga larg	E cila kalëron erën. Shërben si çelës për shërim nga larg. Ka të bëjë me trupin, shpirtin, frymën dhe tërësinë njerëzore.

A) Trajtimi mental (Personi në prani)

Fillo sipas marrëveshjes: Shkalla e parë: laj duart tua. Lutu sipas mënyrës tënde për mbrojtje dhe prosperim dhe falenderohu për faktin që Ti për këtë person ke nderin të shndrrohesh në kanal.
Pastaj lëmoje tri herë aurorën.
Pas herës së katërt shtrije dorën në pozicion të tërthortë nën kokë (dy gishta nën medullë). Dora e djathtë prek pjesën e epërme të kokës (në çakrën e kurorës ose syrin e tretë).
Vizatoje formën e SHK-në dhe CR-në pastaj vëje dorën mbi kapakun e kresë dhe thuaj tri herë me shpirt SHK, CR emrin dhe mbiemrin e personit.
Tashti je një vegël për këtë fuqi shëruese, që përmbanë, në esencën e saj, urtësi dhe dashuri të pafundme. Mos prano premtime të mundshme. Egoja juaj tashmë është shkyqur. Ti mund të thuash me plot përshpëritje shpirtërore: "LE TË NDODHË VULLNETI YT, JO I IMI" dhe lëre tashti fuqinë shëruese të rrjedhë dhe të veprojë. Ky qëndrim është me rëndësi dhe kështu ndodhë për klientët pikërisht ajo që atij edhe më tej i ndihmon, e që për te është element fuqidhënës.
Sipas ndjesisë, ndoshta ti ke nevojë për 4-10 minuta për trajtim mental. Në fund vazhdo me trajtimin përkatës, që ty të përgjigjet.

Trajtimi mental mund të aplikohet edhe në rast lëndimesh fizike të natyrave të ndryshme. Njeriu ka rreth 200 bilion qeliza dhe secila qelizë paraqet intelegjencë të saj specifike, më vete. Në rast se ti bënë trajtim mental të një organi, si psh. të shikës, rrjdha do të ishte si është përshkruar më poshtë.

Edhe CR-ja ndikon aty, ku ti e ndjenë se ke nevojë urgjente.
Atëherë bëje përshkrimin shpirtror të CR-së dhe thuaje shpirtërsiht 3xCR.

Gjatë tërë kohës së trajtimit me klientët, përmes DASHURISË, MIQËSISË dhe NDJESHMËRISË je në lidhje të ngushtë. Këto ndjesi rrjedhin gjatë procesit të trajtimit të klientit te ai dhe dhe kështu

vije edhe deri te ndërlidhja zemër-zemër. Nëse mendimet tua shpërndahen , atëherë kthehu sërish nga fillimi. Në përmbyllje të trajtimit, falenderoje vetveten sërish në mënyrën tënde.

B) Trajtimi nga larg HS + CR

Koha 10 – 15 minuta. Në rast ankesash të mëdha, sipas mundësive, 4 seanca. Parafytyroje fëtyrën e personit mundësisht të madhe, vizatoje me dorë...

1. Mundësia: vizatoje HS dhe thuaj shpirtërisht 3x HS
vizatoje CR dhe thuaje shpirtërisht 3 x CR
shqiptoje shpirtërisht 3 x emrin dhe mbiemrin e personit që i është nënshtruar trajtimit

2. Mundësia: E parafytyron fytyrën e klientit në mes të duarve tua.
Duart tua nuk e prekin atë fare.
Distanca 10 – 20 cm.
Vizatoje shpirtërisht HS-në dhe thuaj shpirtërisht 3xHS.
Vizatoje shpirtërisht CR dhe thuaj shpirtërisht 3x CR .
Thuaj 3x shpirtërisht emrin dhe mbiemrin e personit.

Në fillim të serisë së trajtimit , vepro edhe sipas rrethanave, vetëm në mënyrë të kufizuar ose edhe në tërësi – me tërë pozicionin e duarve. Por, vëre në përdorim vetëm parafytyrimin tënd. Parafytyroje personin në trajtë fare të zvogluar. Ai rri shtrirë në parallërën tuaj, me kokë në prehrin tënd, me fytyrë dhe shikim lart dhe këmbë para teje – të shtrira. Tashti ti ke mundësi t' ia lëvizësh kokën. Pastaj ndrroja pozicionin personit, duke e kthyer në pozitë të tërthortë gjithnjë duke e mbajtur në llërë të duarve, ndërkaq kokën ia kthen në anën e djathtë. Tashti mund t' ja trajtosh pjesën e epërme të trupit. Me qëllim që, trajtimin ta vazhdosh edhe me pjesën tjetër të trupit, personin e rrotullon dhe e kthen në bark. Kështu fare thjesht vazhdon të veprosh. Në përmbyllje sërish falenderoje veten në mënyrën tënde. Personin sille në dritë, tunde dhe ky veprim shkakton shkyçjen e lidhjes me të.

C) Trajtimi nga larg përmes trajtimit mental Koha 15 minuta

Të njejtin veprim si te pika B), pastaj merre personin dhe fillo ta trajtosh në rrugë fare të drejtpërdrejt/trajtim mental (duke vazhduar me pozicione të njëpasnjëshme të kokës (4x):
Vizatoje me dorë në kurorën e çakrës ose në syrin e tretë: të njejtin veprim si te A-ja).
Me këtë simbol unë kam pas përvojë të mrekullueshme. Këtë e aplikoj te çdo trajtim, qoftë ai gjatë kontaktit apo edhe në trajtimin nga larg.

Ti mund ta vështë edhe fotografinë në një kornizë të veçantë qoftë dhe nga një grup i zgjedhur personash, të kryesh procedurën e trajtimit nga larg.

Udhëzime të veçanta:

Është me shumë rëndësi, që gjatë trajtimit nga larg ose edhe nga ai kontaktues, disponimi në nivel, madje para fillimit të seancës. Gadishmëria paraprake dhe harmonia në nivel është pjesë e suksesit gjatë trajtimit të klientit. Në rast se Ti e ndjen vetveten të sëmurë ose edhe të ngarkuar emocionalisht (i zemruar, në vaj etj) atëherë, mundësisht, shtyje trajtimin për një rast tjetër, qoftë trajtimin nga larg, qoftë atë në kontakt të drejtpërdrejt.

Sa më i pastër të jesh Ti vet si kanal, aq më mirë mund t' ju ndihmosh klientëve. Kjo d.t.th. me pak fjalë, se Ti duhet të punosh pa sforcime.

Shkalla e dytë është kërkesë e qetë drejtuar vetvetes, si instrument për t' i ndihmuar vetvetes dhe njerëzve tu. Planeta jonë ka nevojë për këtë lloj ndihme dhe atë urgjentisht.

Ti do të korrësh më shumë, se sa ke mbjellë.

Gurët e çmuar në jetën e njeriut

ACHAT-I: zbutë gjendjen e lartë të zjarrmisë, dhimbjet e lukthit; ndihmon për sëmundjet e syve; për forcimin e gjithanshëm të trupit dhe në veçanti të zemrës.

AMENTHYST-I: ndihmon në raste të mungesës dhe vështërsive për koncentrim (te fëmijët), në rastet e tensionit të ultë, pagjumësia, shtangimet, për tejkalimin e gjendjes dhe ndjesisë së frikës, ndihmon imunitetin ndaj ftohjes, zbut alegjitë.

AVENTURIN-I: ndihmon kundër lagjes (urinimit të pakontrolluar), kundër alergjive të llojeve të ndryshme; shkakton qetësi të brendshme.

KRISTALI SHKËMBOR: ndihmon kundër reumës, dhimbjeve të kokës, jashtëqitjeve, dhimbjes deri në vuajtje nga sytë dhe veshët, ankesave nga vrerri, pengesave për gjumë të mirë, ankesa gjatë menstracioneve.

CARNEOL-I: ndihmon në rast dhimbjesh së pjesës të poshtme të barkut, është i mirë për tretje, në trajtimin e veshkëve i preferueshëm.

CHALZEDON-I: i mirë për shpretkë, për palcë, bajame, ndihmon gjatë thithjes (së gjirit nga fëmija), te rastet e ntrashjes së limpfës, çrregullimet në qarkulliin e gjakut.

CITRIN-I: ndikon fuqishëm si element antidepresiv, kundër stresit, ndihmon në rast nervozizmi, ndihmon kur kemi të bëjmë me pastërtine e lëkurës, dhimbjet e barkut.

HEMATIT-I: ndihmon në rast mungesës së gjakut, shtangimeve, migrenës, shtangim të pulpave (të këmbëve), rregullator shumë i mirë i stabilizimit të gjakut, zgjon gjakun dhe organet.

JADE-ja: ndikon në zemër, veshkë, pjesën e epërme të kokës, mëlçi të zezë, ndikon poyitivisht te gjëndrrat tiroide dhe në shpretkë, ulë temperaturat e larta – ethet.

JASPIS-I: ndihmon kundër alergjive (ekcemës), sëmundjeve tjera të lëkurës, forcon sistemin e imunitetit, ndihmon kundër rraskapitjes, pastaj gjatë lindjes, ka efekt kundër helmeve në gjak, ka efekte qetësues në rastet e ëndrrave të trishta.

LAPISLAZULI: harmonizon shtypjen e gjakut, ndihmon kundër djegjes së mëshikzave, në rast problemesh me ezofag, me gurmaz dhe me bronshien e epërme.

MALAHIT-I: për forcimin e syve, veshkëve, shpretkës, lukthit, ndihmon në rastet e sëmundjeve të zemrës, astmës, të rënit të fikët, reumës, frikës nga e kaluara, ka ndikim kundër ndezjeve të natyrave të ndryshme.

GURI I HËNËS: forcon lukthin, ndihmon kundër kapsit, shtangimeve, dhimbjeve gjatë menstracioneve, varësisë nga uji, thyerjes së eshtrave, në rast jofrutshmërisë te gratë etj.

ONYX-i: forcon zemrën, veshkët, nervat, ka efekte zbutëse kundër apatisë dhe stresit, forcon eshtrat dhe dhëmbët.

QUARCËT E TRËNDAFILTË: të mirë për yemër, si mjetë ndihmës për gjumë, ndihmon kundër rreyatimeve nga toka, komjuteri dhe televiyori, ndikon pozitivisht në rast depresionesh, kundër dhimbjeve të nyjeve, sëmundjeve të gjakut dhe qarkullimit të tij.

QUARCI I TYMTË: përndryshe është si kristali shkëmbor; ka efekte pozitive për lënjen e duhanit, respektivisht shprehisë së pirjes së duhanit.

QUARCI RUTIL: ybutë vështeërsitë e mëshkrive, ftohjet, ndikon kundër kollës, bronhitit, ybut shqetësimet dhe frikën.

OBSIDIANI NË FORMË TË FJOLLAVE TË BORËS: është i mirë kundër dhimbjeve të shpinës, derdhjeve të gjakut, plagëve, ndikon në dobi të eshtrave dhe nyjeve të muskujve.

SODALIT-I: ndihmon në rast tensioni të lartë, në rastë të vështërsive për koncentrim, depresioni; qetëson nervat, stimulon qarkullimin e materieve si oksigjeni etj...

SYRI I TIGRIT: kundër vështërsive në frymëmarrje, shtangimeve të yorrës së trashë, astmës; nxit gjykim të shëndosh, vitalitet, ndihmon kundër vështersive dhe lëngatave të syve.

Përulja

është thjeshtësi dhe maturi

Definicioni sipas civiliyimit kristian:
Jo nënvleftësimi ndaj njerëzve, por shoqërimi me Zotin dhe mbrojtja e tij në raport me njerëzit dhe fatin – kjo të ndihmon nga vetlavdrimi.

Definicini filozofik dhe ai teologjik:

Përulja e mirëfilltë është ngjitje drejt dinjitetit hyjnor, lirisë dhe dashurisë.

Këtë përulje, si veti do të duhej ta mbronim, në rast se paraqet efekte shëruese. Nuk kam qenë unë ai që të ka shëruar ty, por ke qenë ti ai që mua më ke shfrytëzuar si instrument perceptues.

Reiki nuk është farë dhuruese i dashurisë, por as edhe i kënaqësisë, ndjesisë, maturisë dhe thjeshtësisë. Kjo fuqi hyjnore do të ketë efekte pozitive te ne, do të ndikojë për ndrrime poyitive, nëse ne vemi veten në dispozicion si përceptues. Ne kemi vet mundësi të zgjedhim sipas vullnetit të lirë.

Le të mbesim tek tema, le të provojmë edhe më tej të jemi të vetvetes, ata që jemi. Ky "JAM UNË", i pathyeshëm, qenie hyjnore me një të kaluar, trup fizik.
Meditimi i përditshëm do t' na ndihmojë, që ta përceptojmë zërin tonë të brendshëm.
Reiki dhe meditimi është një kombinim shumë i mirë, që ta mbajmë veten si qenie kreative. Të fillojmë që tashti në këtë fushë, me disiplinë dhe këmbëngulje.

Simboli i parë: CHO KU REI (CR) lexo: Sho ku ree

Simboli i dritës ose simboli i fuqisë shëruese - simboli kryesor i shpejtë si vetëtima

Energjia hyjnore dhe universale është këtu në këtë vend, ku unë kam orjentuar vëmendjen time. Ose e tërë energjia nga Universi vije në këtë vend. CR-ja vije nga "pafundësia në pafundësi" ose "nga Qendra në Qendër". Energjia sillet nga rrafshi hyjnor dhe ai kozmik në atë fizik dhe ndikon menjëherë.
E Pavetëdijshmja fiton më shumë energji.

Detyra e CR-së

Në njërën anë është përgjegjëse për zhvillimin dhe për transformimin, respektivisht shndrrim. Energjia sjell esencën negative dhe e transformon atë.

Qëllimi: Të sillet Universi tek ne, në qenien tonë. Ndërlidhja e sërishme me burimin, respektivisht dritën universale-/Energjinë jetësore.

Kuptimi i Mantrave:

CHO	Shpatë e shtrembër, që tërheqë një vijë poashtu të shtrembur.
KU	Depërtim; që të krijohë një të plotë, aty ku nuk ka asgjë.
REI	Shpirt transcendental, fuqi misterioze.

CHO KU REI Është simbol i fuqisë së Reikit, një aktivizues dhe përforcues i energjisë, por edhe një mbajtës i fuqishëm i simboleve tjerë.

Kuptimi i numrave

1	Unë shkoj në pafundësi.
2	E kapi fundësinë.
3	Mbushem dhe vijë me plot energji në qenësinë hyjnore.

Ji i vetëdijshëm si “Shërues”-Reiki, përherë i vetëdijshëm,
Se ti “vetëm” një kanal je, përmes të cilit
Rrjedh energjia hyjnore.
Besoji energjisë dhe lëre të rrjedh,
Pa bërë dhe aqë të vlefshme dëshirën tënde.
Kjo energji intelegjente gjenë
Përherë rrugën e mirëfilltë pët të ndikuar.
Përulje, urtësi, kënaqësi dhe
Dashuria e mirëfilltë janë dëshmi të dashurisë së mirëfilltë.
Beso në të mirën në jetë dhe bëhu

Bartës i energjisë.

Detyra pa dashuri të bënë të të mërzitur e të grysur.
Përgjegjësia pa dashuri të bënë të pakujdesshëm
Drejtësia pa dashuri të bënë të ashpër.
E vërteta pa dashuri të bënë kritizer
Edukata pa dashuri të bënë të pabindur
Mençuria pa dashuri të bënë dinak
Miqësia pa dashuri të bënë hipokrit
Rendi dhe rregulli pa dashuri të bënë cikrrimtar.
Të qenunit ekspert pa dashuri të bënë hokatar
Fuqia pa dashuri të bënë kriminel.
Nderi pa dashuri të bënë mendjemadh
Pasuria pa dashuri të bënë koprrac
Besimi pa dashuri të bënë fanatik.

(ANONIMI)

Simboli i dytë: SEI HE KI (SHK) lexo: Zee he ki

Simboli për shërim mental – Simboli I harmonisë
Rojtar – Drangua
Rendi në rrafshin psikologjik

Ky simbol është një ndihmës për zhvillim. Ai sjell gjëra nga rrafshi i pavetëdijes në atë të vetëdijes. Fuqia e këti simboli nxit spastrimin e brendshëm. Faqet e errëta të shpirtit zgjohen, bëhen të njohura dhe mund të shpërrftyrohen, në rast se kujtesa jonë dhe qëndrimi ynë tregojnë gadishmëri për që ato të ndrrojnë.
Në këtë rast aktivizohet trupi mental dhe vije deri të një ngjashmëri e theksuar e tij me atë realin, fizikun. SHK –ja është një mbrojtës dhe rojtar; ai simbolizon drangojt kinez. Përmes këti simboli ndjenjat tona, emocionet, intelekti dhe mendimi, pastaj institucioni, kreativiteti dhe trupi i ndjeshëm vijnë e përshtaten rrethanave. Ai ndikon në mënyrë të veçantë në rrafshin shpirtëror. Zoti dhe njeriu njësohen.

Shprehur në mënyrë përmbledhëse, konstatojmë se, se ky simbol mbështetet në tri shtylla:

1. Shtylla e parë: Spastrimi, kjo d.t.th. të lirohemi nga gjësendet që nuk na takojnë neve.

2. Shtylla e dytë: Forcon lidhjen me majat e vet ndërgjegjes sonë.

3. Shtylla e tretë: Energjia hyjnore dhe ajo univerzale na ndihmon neve, që t' i njohim detyrat tona. Fusha jonë energjetike bëhet më e fuqishme dhe kështu energjitë tona të stivosura në thellësinë e qenies sonë, sërish të gjetura, do të mbahen, respektivisht do të ruhen dhe transformohen. Parakusht për këtë është vetëm ndjesia me takt, fare e lehtë dhe orjentimi i drejtë i gjykimit personal, respektivisht sferës së vetëdijes.

Detyrat dhe qëllimet e SHK-së

Sjell harmoni dhe ekuilibrim në rrafshin e ndjesisë së hollë. Na mbronë dhe na ruan. Sjell harmoniyimin në rrafshin psiqik.

Kuptimi i mantrave

SEI Gjendje embrionale. Gjëra që janë në stadin para lindjes.

HE KI	Gjendjen e çekuilibruar ka për detyrë ta balancojë.
SE HE KI	Të bëjë shpërthimin e bllokadave,nxitjen e harmonisë Yin / Yang – barazpeshim.

Kuptimi i numrave

1 Ngritem në lartësi vet, që në fëmijëri.
2 Ndërtoj mekanizmin mbrojtës.
3 Unë e kam çelësin dhe mbyllem, duke vënë veten në rojë të vetvetes.

Simboli i tretë: HON SHA ZE SHO NEN (HS)
Lexo: Hon sha she shooon

Simboli për shërim nga larg – Simboli kontaktues

Kush kalëron erën

Nga libri i jetës marr në duar këtë person ose këtë gjë dhe i dërgojë atij fuqi hyjnore. Pra vejmë kontakte hyjnore dhe ndërlidhim unin e njëri-tjetrit, ndërkaq në mua dhe në ty ka diçka hyjnore dhe menjëherë fillon të rrjedh tek të dytë energji shëruese, poashtu hyjnore. Ajo e përthekon trupin, shpirtin, frymën dhe tërë qenien njerëzore, në tërë rrafshin e lëkudjes shpirtërore.

Detyrat e HS-së

HS-ja shërben si çelës për shërim nga larg dhe ndërlidhë të gjithë trupat me njëri-tjetrin. Diamanti i lashtë dhe i pazbuluar në vete, përmes HS-së do të aktivizohet dhe fillon të zhvillojë vetveten.

Qëllimi Ta zgjojë vetëdijen kristiane në vet njeriun.

Kuptimi i mantrës

HON	Lashtësia. Fillimi.
SHA	Të zbardhojë.
ZE	Të ndërlidhë në kursin e mirëfilltë.
SHO	Qëllimi.
NEN	Heshtja, qetësia në qenësi.

HON SHA ZE SHO NEN Të shkarkojë energjinë dhe të hap shpirtin, me qëllim që energjia të mund të veprojë në hapësirë dhe kohë.

Kuptimi i numrave

1	Unë shkoj në pafundësi.
2	Kap fundësinë.
3+4	Ndërton kanalin hyjnorë.
5	Kujtoj pafundësinë.
6	Kam nevojë për bazën.
7	Për një urë.
8+9	Për shtëpinë.
10	Të ndërtojë njeriun
11	Për këtë toka është bazë.
12	Vete ne thellësi.
13	Nga jashtë kujtoj pafundësinë.
14	Ndërtojë mekanizmin mbrojtës.
15+16	Për qenësinë e kanalit hyjnorë në tokë.
17	Pa fillim, pa fund.
18	Kam qasje në brendinë e fëmijës.
19	Gëzhojën hyjnore.
20+21	Vë duart plot besim në qenësinë time.

Kështu jam një kanal i denjë për fuqinë shëruese hyjnore

"Shëruesi I shenjtë"- sipas rrëfimit "Hijet e shenjta"

Para shumë e shumë kohësh na jetonte një njeri i shenjtë, i cili na ishte aq i mirë, sa i pat habitur edhe vet engjujt e zbritur nga qielli, tek erdhën për ta parë se si është e mundur, që të jetë një njeri kaq i ngjashëm me Zotin. Ai ndiqte fare thjeshtë rrugën e tij, kryente obligimet e përditshme dhe kështu rrezatonte dritë e mirësi, ashtu si një yll drite ose si një lule që lëshonë aromë rreth e pqrqark, madje edhe pa qene i vetëdijshëm për atë.

Na ishin dy nocione me të cilat ai një ditë pati punë serioze: **jap** dhe **shpërndaj**. Pastaj këto dy fjalë më nuk u nxorën nga goja e tij. Por, në fakt, ato reflektoheshin shumë më shumë në fytyrën e tij plot nur, në buzagayin e tij, në dashurinë dhe vullnetin që reflektonte kudo.

Engjujt vajtën një ditë dhe i thanë Perendisë: "O Zot' ynë, përmbushja një dëshirë këti njeriu të mirë". Zoti qe përgjegjur: "Dakord", pyeteni atë se çfarë don. "Çfarë të do yemra, o njeriu i mire?" e pyetën engjujt atë. "Çfarë do të duhej të doja unë?", pyeti njeriu i shenjtë buzagaz. Me që Zoti ma dëshmon bekimin e Tij, a nuk do të duhej që me këtë t'i kisha të gjitha? Engjujt megjithëkëtë, këmbëngulën në qëndrimin e tyre. Ti do të duhej të luteshe për farë mrekullie, ose do të të imponohet. Mirë, tha njeriu i shenjtë, atëherë dëshirë e imja le të jetë ajo që unë të bëjë shumë të mira, edhe pa qenë i vetëdijshëm, respektivisht edhe pa u vënë unë në dijeni për të. Engjujt dyshuan se mos shprehja e kësaj dëshire na ishte thjesht një lojë fjalësh. U këshilluan me njëri-tjetrin dhe morën qëndrim rreth një plani të paramenduar. Saherë që hija e njeriut të shenjtë të bie mënjanë, ashtu që ai atë të mos ketë mundësi ta vërejë, qoftë ajo prapa tij apo anash, do të duhej të ketë fuqi dhe ta ketë të mundur që t'i

shërojë sëmundjet, t'i zbusë dhimbjet dhe të shpërndajë shqetësimet.

Ashtu edhe ndodhi. Kudo që bridhte njeriu i shenjtë, hija e tij linte gjelbrim pas, i ringjallte bimët e thara dhe i bënte ato të mugullojnë plotë jetë; burimet e shterrura po i bënte të shpërthejnë plot ujë; fytyrave të zbehura të fëmijëve ua kthente gjallërinë, gazin e jetës e nënave jua rikthente shpresën dhe kënaqësinë për jetë.

Njeriu i shenjtë bënte një jetë të zakonshme dhe rrezatonte plot dashuri, ashtu si një yll –dritë dhe si një lule – aromë, pa qenë i vetëdijshëm për këtë. Njerëzit e respektonin përuljen e tij dhe e ndiqnin atë pa zë; nuk flisnin kurrë për mrekullitë e tij. Ditë pas ditësh, madje, harronin edhe emrin e tij dhe e thërrisnin vetëm "I shenjëti".

Ky rrëfim i përgjigjet për mrekulli Reikit dhe mund t'na prekë e mallëngjeje ne të gjithëve. Të japësh dhe të shpërndash janë vetëmfjalë, akcente, me të cilat ne në jetën tonë shpesh konfrontohemi. Këtë model të këti të shenjëti pse mos ta kemi në mendje edhe ne: "Të bëjmë shumë të mira, pa pas nevojë që të jemi në dijeni për atë".

Paralel me këtë, është detyrë jona, që çdo ditë të punojmë me vetveten, ashtu që mundësisht të bëhemi kanal i denjë për frymën dhe energjinë hyjnore. Të punosh në këtë drejtim d.t.th. para vetvetes të jemi fare të sinqertë. Dhe si të bëhemi deri në fund të sinqertë para unit, qenies sonë? Të supozojmë se, unë isha një i përkryer. Në debatin pauses, qoftë ai edhe shumë I nxehtë, unë nuk do të jemë këmbëngulës në mbrojtjen me çdo kusht të opinionit tim, edhe nëse kam bindje të plotë se kam të drejtë, por lëshoj mençurisht pe, pa humbur fytyrën, qoftë edhe para vetvetes.

Të dëshiroj kohë ...

Dua dhe dëshirojë të kishe të gjitha dhuntitë e mundshme; uroj që të kesh atë që nuk e kanë shumica. Dua që të kesh kohë për t'vepruar dhe shestuar, që ta gëzosh vetveten, që ta bësh veten të qeshur, pra edhe të lumtur, dhe, nëse ajo të shërben, mund edhe ta shfrytëzosh.

Dua dhe të dëshirojë të kesh kohë për veprim dhe shestim, jo vetëm për vetveten, por edhe për të tjerët. Të dëshiroj t'keshë kohë, jo vetëm për t'rendur dhe nxituar, por kohë që të mjafton për kënaqësi edhe personale.

Dua dhe të dëshirojë kohë, jo thjeshtë që ta keshë atë. Të dëshiroj kohë të mjaftueshme, aq sa të keshë mundësi ta shfrytëzosh sa e si duhet.

Dua dhe të dëshirojë kohë, që të mund të pretendosh majat, yjet; të dëshiroj kohë të mjaftueshme për ngjitje personale, kjo d.t.th. kohë për pjekuri të plotë.
Dua dhe të dëshirojë kohë për shpresa e dashuri të reja. Nuk do të kishte kuptim që këtë kohë të mos e shfrytëzosh.

Dua dhe të dëshirojë kohë, parasëgjithash për vetveten, çdo ditë, pse jo edhe për të pranuar lëshimet a gabimet e mundshme. Të dëshirojë kohë të mjaftueshme, që edhe gabimet e të tjerëve në raport me ty, t'jeshë në gjendje t'i kuptosh dhe ata t'i falësh.
Të dëshirojë kohë të mjaftueshme për jetë.

Shtatë ligjet themelore të shërimit sipas metodës së Reikit

Energjia – Reiki nuk mundet dhe nuk guxon të vihet në veprim me detyrim. Aktivizimi dhe ndikimi i saj është i pavarur nga besimi (religjioni) ose nga dëshira e vetëdijshme e klientit. Ajo mund të trajtohet , por edhe të ndikojë në mënyra e forma të ndryshme dhe me intenzitet të ndryshëm nga klienti në klient. Por mund të ngjajë

që, energjia e Reikit në një rrafsh a tjetër të trupit të mos arrijë të depërtojë.

Energjia-Reiki nuk atakon drejtpërdrejtë trupin, porn parasëgjithash pjesët e tij të veçanta, duke i nxitur ato për reagim gradual. Reiki nuk nxitë dhe provokon kurrë disharmoni ose sëmundje.

Secili veprim shërues përmes energjisë së reikit ka rrjedhë të natyrshme.

Energjia – Reiki nxit sistemin jetësor, duke stimuluar angazhimin personal dhe mundësitë për përqëndrim. Ajo nuk atakon as në materiet për shfrytëzim të përditshëm (oksigjen etj), por as edhe psikën.

Sa më shumë që sëmundja ndikon në psikën e individit, aq më tepër klienti do të duhej të motivohej për angazhim personal në drejtim të mundjes së saj; kjo d.t.th. se ai do të duhej të posedoje dëshirë dhe vullnet të fort për shërim.

Energjia – Reiki mund të ndikoj edhe më mirë, sa më shumë që i krijohet hapësira dhe liria e veprimit në trup, mendje e shpirt.

Energjia – Reiki atë që është përfundimisht e shkatrruar nuk mund ta shëroj (me aq sa kemi njohuri sot, aktualisht). Në këtë rast mbetet vetëm edhe mundësia e mbështetjes, respektivisht përkujdesit ndaj trupit të tillë, që vazhdon megjithatë të jetë në jetë. Përmes një mbështetje të tillë mundet që i tërë trupi të ndjeje sado pak prehje.

Perkthimin dhe editimin e këtij doracaku në internet e përgatiti dhe e autorizoi:

HIDAJET BYTYQI

PARAPSIKOLOGJIA DHE MJEKËSIA ALTERNATIVE JANË NË SHËRBIMIN TUAJ

Pas hulumtimit shumë vjeçar eksperimental tek shumë pacient që vuajnë nga sëmundjet e ndryshme.
HYPNO-AKUSTIKO-TERAPIA përmes ndëgjimit të audiokasetave që kanë bekimin magjik dhe janë formuluara me sugjestione adekuate verbale, ku me ndihmën e drejtëpërdrejtë në ndërdijen e njeriut, ku edhe realisht është shkaktari kryesor latent i sëmundjes konkrete.
Kjo metodë është origjinale dhe për here të pare zbatohet nga parapsikologu terapeut, HIDAJET BYTYQI duke patur rezultate senzacionale tek shumë sëmundje që në fillim duken gati të pashërueshme për medicinën bashkëkohore.
Kjo qendër organizon kurse kualifikuese për bioenergji, hipnozë dhe magjistari.
Pas shumë vitesh të suksesshme në Cyrih të Zvicrës,Qendra Parapsikologjike tash vepron në Prizren.
Psikoterapeuti, **HIDAJET BYTYQI**, me medicinën tradicionale kineze me hipnozë, regresion hipnotik,barna popullore.
Mjekon problemet në baza psikike,sëmundjet posttraumatike, neurozat,pagjumësinë, alergjinë,halucinacionet, frikësimet e ndryshme, sterilitetin tek femrat,bashkimin dhe zgjedhjen e fatit, koncentrimin në provime, urinimin në shtrat, belbëzimin etj.
Mundemi t’ ju ndihmojmë edhe pa prezencën e pacientit.

QENDRA PARAPSIKOLOGJIKE
HIDAJET BYTYQI
Rr. Iliaz Kuka nr. 24 Prizren
Informatat më të hollësishme përmes
Mob. 044-134-621 dhe
Tel. 038-633-218